<p>1. Ministria jep lejen me kërkesën e subjektit.</p> <p>2. Lejen e nënshkruan Ministri.</p> <p>3. Ministri me akt nënligjor përcakton procedurat dhe kriteret e aplikimit, evidentimit, shqyrtimit, dhënies, përtëritjes, plotësimit, refuzimit, revokimit dhe pezullimit të lejeve. Për përtëritjen dhe plotësimin e lejes parashihen procedura të thjeshtuara.</p> <p>4. Ministri me akt nënligjor përcakton tarifat për shqyrtimin e aplikimit, dhënien, përtëritjen dhe plotësimin e lejes, sipas llojit. Tarifa caktohet në lartësinë e nevojshme për të mbuluar shpenzimet e shqyrtimit të aplikimit dhe të administrimit të lejes për kohëzgjatjen e vlefshmërisë.</p> <p>5. Drejtori i Departamentit nxjerr vendim për lejen brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të aplikimit. Departamenti mund të kërkojë dokumentacion shtesë ose verifikim të dokumentacionit brenda këtij afati.</p>	<p>1. The Ministry shall issue the permit at the request of the entity.</p> <p>2. The permit is signed by the Minister.</p> <p>3. The Minister shall, through a sub-legal act, determine the procedures and criteria for application, record, review, issuance, extension, completion, rejection, revocation and suspension of permits. For renewal and completion of the permit simplified procedures are provided for.</p> <p>4. The Minister shall, through a sub-legal act, determine the fees for reviewing the application, issuing, extension and completion of the permit, by type. The fee shall be determined at the level necessary to cover the costs for reviewing the application and administering the permit for the duration of the validity.</p> <p>5. The Director of the Department shall issue a decision on permit within thirty (30) days from the date of submission of the application. The Department may request additional documentation or verification of documentation within this deadline.</p>	<p>1. Ministarstvo izdaje dozvolu na zahtev subjekta.</p> <p>2. Dozvolu potpisuje ministar.</p> <p>3. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje postupke i kriterijume za apliciranje, evidentiranje, razmatranje, izdavanje, obnavljanje, dopunu, odbijanje, oduzimanje i suspenziju dozvola. Za obnovu i dopunu dozvole predviđene su pojednostavljene procedure.</p> <p>4. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje tarife za razmatranje aplikacije, izdavanje, obnavljanje i dopunu dozvole, prema vrsti. Tarifa je određena na nivou neophodnom za pokrivanje troškova razmatranja aplikacije i upravljanja dozvolom za vreme važenja.</p> <p>5. Direktor Odeljenja donosi odluku o dozvoli u roku od trideset (30) dana nakon podnošenja aplikacije. Odeljenje može zatražiti dodatnu dokumentaciju ili verifikaciju dokumentacije u ovom roku.</p>

<p>6. Departamenti i dorëzon subjektit vendimin për refuzim, revokim ose pezullim brenda shtatë (7) ditëve pas nxjerrjes së vendimit. Dorëzimi bëhet fizikisht ose përmes postës elektronike.</p>	<p>6. The Department shall deliver, physically or via email, to the entity the decision for rejection, revocation or suspension within seven (7) days from the day the decision was made.</p>	<p>6. Odeljenje dostavlja subjektu odluku o odbijanju, oduzimanju ili suspenziji u roku od sedam (7) dana nakon donošenja odluke. Dostava se vrši fizički ili putem e-pošte.</p>
<p>7. Departamenti i dorëzon Ministrit vendimin për dhënien, përtëritjen ose plotësimin e lejes menjëherë pas nxjerrjes së vendimit. Ministri nënshkruan lejen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi i dorëzohet vendimi i Departamentit.</p>	<p>7. The Department shall submit to the Minister the decision for issuing, extension or completion of the permit immediately after the issuance of the decision. The Minister shall sign the permit within fifteen (15) days from the date the decision of the Department has been delivered.</p>	<p>7. Odeljenje dostavlja ministru odluku o izdavanju, obnavljanju ili dopuni dozvole odmah po donošenju odluke. Ministar potpisuje dozvolu u roku od petnaest (15) dana po prijemu odluke Odeljenja.</p>
<p>8. Ministri ia kthen Departamentit për rishqyrtim vendimin për dhënien, përtëritjen ose plotësimin e lejes, nëse vlerëson se nuk janë zbatuar kërkesat ose procedurat ligjore.</p>	<p>8. The Minister shall return the decision for issuing, extension or completion of the permit to the Department for reconsideration, if it considers that legal requirements or procedures have not been applied.</p>	<p>8. Ministar vraća Odeljenju na ponovno razmatranje odluku o izdavanju, obnavljanju ili dopuni dozvole, ako oceni da zakonski zahtevi ili postupci nisu sprovedeni.</p>
<p>9. Subjekti ka të drejtë ankese ndaj vendimit të Departamentit. Ankesa parashtrohet brenda tri dhjetë (30) ditëve pasi subjektit i dorëzohet vendimi për refuzimin, revokimin ose pezullimin e lejes.</p>	<p>9. The entity shall have the right to appeal against the decision of the Department. The appeal shall be filed within thirty (30) days from the date the decision for rejection, revocation or suspension of the permit is delivered to the entity.</p>	<p>9. Subjekat ima pravo žalbe na odluku Odeljenja. Žalba se podnosi u roku od trideset (30) dana nakon što je subjektu dostavljen odluka o odbijanju, oduzimanju ili suspenziji dozvole.</p>
<p>10. Nëse Ministria nuk nxjerr vendim brenda dyzet e pesë (45) ditëve pas aplikimit për leje, subjekti ka të drejtë të ushtrojë veprimtarinë përkatëse deri kur Ministria të nxjerrë vendim.</p>	<p>10. If the Ministry does not issue a decision within forty five (45) days after applying for a permit, the entity shall have the right to exercise relevant activity until the Ministry issues a decision.</p>	<p>10. Ako Ministarstvo ne donese odluku u roku od četrdeset pet (45) dana nakon podnošenja aplikacije za dozvolu, subjekat ima pravo da obavlja odgovarajuću delatnost dok Ministarstvo ne donese odluku.</p>
<p>11. Subjekti duhet ta tërheqë lejen e nënshkruar brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pasi njoftohet.</p>	<p>11. The entity must withdraw the signed permit within fifteen (15) days after being notified.</p>	<p>11. Subjekat treba podići potpisanu dozvolu u roku od petnaest (15) dana nakon što je obavešten</p>

<p style="text-align: center;">Neni 9 Përtëritja e lejes</p> <p>1. Subjekti aplikon për përtëritjen e lejes të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë por jo më herët se njëqind e njëzet (120) ditë para skadimit të lejes.</p> <p>2. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes së përtëriturë fillon pas ditës së skadimit të lejes së mëparshme.</p> <p>3. Nëse subjekti nuk aplikon për përtëritje të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë para skadimit të lejes, subjekti duhet të aplikojë për leje si për herë të parë. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes së re fillon ditën e lëshimit të lejes ose pas ditës së skadimit të lejes së mëparshme, cilado që është më e vonshme.</p> <p>4. Dispozitat për dhënien e lejes zbatohen përshtatshëm për përtëritjen e lejes.</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Extension of a permit</p> <p>1. The entity shall apply for permit extension at least sixty (60) days, but not earlier than one hundred and twenty (120) days before expiration of the existing permit.</p> <p>2. The validity term of the extended permit starts from the expiry of the previous permit.</p> <p>3. If entity does not apply for extension at least sixty (60) days before expiration of the permit, then the entity must apply for the permit as for the first time. The validity period of the new permit starts on the day the permit was issued or the date of expiration of the previous permit, whichever is the latest.</p> <p>4. Provisions on issuing permits shall be applied accordingly for permit renewal.</p>	<p style="text-align: center;">Član 9 Obnova dozvole</p> <p>1. Subjekat aplicira za obnavljanje dozvole najmanje šezdeset (60) dana, ali ne ranije od sto dvadeset (120) dana pre isteka dozvole.</p> <p>2. Period važenja obnovljene dozvole počinje nakon dana isteka prethodne dozvole.</p> <p>3. Ako subjekat ne aplicira za obnavljanje najmanje šezdeset (60) dana pre isteka dozvole, subjekat mora da aplicira za dozvolu kao po prvi put. Period važenja nove dozvole započinje danom izdavanja dozvole ili nakon isteka roka prethodne dozvole, koja god je poslednja.</p> <p>4. Odredbe o izdavanju dozvole prikladno se primenjuju za obnavljanje dozvole.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10 Pezullimi dhe revokimi i lejes</p> <p>1. Leja mund të pezullohet ose të revokohet nëse:</p> <p>1.1. subjekti ose personi përgjegjës i subjektit ka aplikuar praktika mashtruese tregtare ose ka shkelur ndonjë dispozitë të ligjeve ose të akteve nënligjore përkatëse;</p>	<p style="text-align: center;">Article 10 Suspension and revocation of permit</p> <p>1. A permit may be suspended or revoked in cases when:</p> <p>1.1. the entity or the responsible person of the entity has applied fraudulent trade practices or has infringed provision of the respective laws or sub-legal acts;</p>	<p style="text-align: center;">Član 10 Suspenzija i oduzimanje dozvole</p> <p>1. Dozvola može biti suspendovana ili opozvana ako:</p> <p>1.1. subjekat ili odgovorno lice subjekta je primenjivalo obmanjujuće komercijalne prakse ili kršilo bilo koju odredbu relevantnih zakona ili podzakonskih akata;</p>

<p>1.2. subjekti pushon së përmbushuri kriteret e lejes;</p> <p>1.3. subjekti i pajisur me leje ka paraqitur dokumentacion të pavlefshëm ose të rremë, në aplikimin për leje ose gjatë mbiqyrjes;</p> <p>1.4. subjekti nuk pastron, mirëmban ose kontrollon rezervuarin sipas nenit 16 të këtij ligji.</p> <p>2. Vendimi për pezullimin ose revokimin e lejes mbështetet në faktet e konstatuara me vendim të prerë të organit kompetent ose të gjykatës.</p> <p>3. Leja pezullohet nëse shkak i pezullimit mund të sanohet brenda njëqind e njëzet (120) ditëve; përndryshe leja revokohet.</p> <p>4. Vendimin për pezullimin ose revokimin e lejes e nxjerr Ministri.</p>	<p>1.2. the entity ceases to fulfil the permit's criteria;</p> <p>1.3. the entity with the permit has presented invalid or fraudulent documentation in the application for a permit or during supervision.</p> <p>1.4. the subject does not clean, maintain or control the tank according to article 16 of this law.</p> <p>2. The decision to suspend or revoke the permit is based on the facts established by a final decision of the competent body or the court.</p> <p>3. The permit is suspended if the cause of the suspension can be remedied within one hundred and twenty (120) days; otherwise the permit is revoked.</p> <p>4. The decision to suspend or revoke the permit is issued by the Minister.</p>	<p>1.2. subjekat prestaje da ispunjava kriterijume dozvole;</p> <p>1.3. subjekat opremljen dozvolom je podneo nevažeću ili lažnu dokumentaciju, u aplikaciji za dozvolu ili tokom nadzora;</p> <p>1.4. subjekt ne čisti, ne održava i ne kontroliše rezervoar u skladu sa članom 16. ovog zakona.</p> <p>2. Odluka o suspenziji ili oduzimanju dozvole zasniva se na činjenicama utvrđenim pravosnažnom odlukom nadležnog organa ili suda.</p> <p>3. Dozvola se suspenduje ako se uzrok suspenzije može otkloniti u roku od sto dvadeset (120) dana; u suprotnom dozvola se oduzima.</p> <p>4. Odluku o suspendovanju ili oduzimanju dozvole donosi ministar.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Komisioni i Ankesave</p> <p>1. Komisioni i Ankesave shqyrton ankesat ndaj vendimeve të Drejtorit të Departamentit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Appeal Committee</p> <p>1. The Appeal Committee shall review appeals against the decisions of the Director of the Department.</p>	<p style="text-align: center;">Član 11 Komisija za žalbe</p> <p>1. Komisija za žalbe razmatra žalbe na odluke direktora Odeljenja.</p>

<p>2. Komisioni i Ankesave përbëhet prej tre (3) anëtarëve, të cilët i emëron Ministri. Mandati i Komisionit të Ankesave zgjat tri (3) vjet.</p> <p>3. Komisioni i Ankesave mblidhet sipas nevojës dhe shqyrton ankesat brenda tridhjetë (30) ditëve pas dorëzimit të ankesës, në përputhje me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.</p> <p>4. Pala e pakënaqur mund të nisë konflikt administrativ në gjykatë ndaj vendimit të Komisionit të Ankesave.</p> <p>5. Komisioni i Ankesave i përgjigjet për punën e vet Ministrin.</p>	<p>2. The Appeal Committee shall consist of three (3) members, which are appointed by the Minister. The mandate of the Appeal Committee is three (3) years.</p> <p>3. The Appeal Committee shall meet as needed, and shall review the appeals within thirty (30) days after lodging the appeal, in accordance with the Law on General Administrative Procedure.</p> <p>4. The unsatisfied party may initiate an administrative dispute with the court against the decision of the Appeal Committee.</p> <p>5. The Appeal Committee for its work reports to the Minister.</p>	<p>2. Komisija za žalbe sastoji se od tri (3) člana, koje imenuje ministar. Mandat Komisije za žalbu traje tri (3) godine.</p> <p>3. Komisija za žalbe saziva se po potrebi i razmatra žalbe u roku od trideset (30) dana nakon podnošenja žalbe, u skladu sa Zakonom o opštem upravnom postupku.</p> <p>4. Nezadovoljna stranka može pokrenuti upravni spor na sudu protiv odluke Komisije za žalbe.</p> <p>5. Komisija za žalbe za svoj rad odgovara ministru.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Cilësia e karburanteve</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Quality of fuels</p>	<p style="text-align: center;">Član 12 Kvalitet goriva</p>
<p>1. Qeveria me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përcakton standardet dhe mënyrën e verifikimit të cilësisë së karburanteve.</p> <p>2. Subjektet kanë detyrë të garantojnë cilësinë e karburanteve që importojnë ose tregtojnë në Republikën e Kosovës.</p> <p>3. Shpenzimet e verifikimit mund t'i caktohen subjektit.</p>	<p>1. The Government shall, through a sub-legal act proposed by the Minister, determine the standards and manner of verifying the quality of fuels.</p> <p>2. The entities shall be obliged to guarantee the quality of fuels they import or trade in the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Verification costs shall be carried out by the entity.</p>	<p>1. Vlada podzakonskim aktom koji je predložio ministar utvrđuje standarde i način provere kvaliteta goriva.</p> <p>2. Subjekti su dužni da garantuju kvalitet goriva koje uvoze ili trguju u Republici Kosovo.</p> <p>3. Troškovi verifikacije mogu se dodeliti subjektu.</p>

<p>4. Cilësia e karburanteve verifikohet përmes testeve laboratorike. Mostra merret në përputhje me paragrafin 2 të nenit 17 të këtij ligji.</p>	<p>4. Fuel quality verification is done through laboratory testing. The sample is taken in accordance with paragraph 2 of article 17 of this law.</p>	<p>4. Kvalitet goriva se proverava laboratorijskim ispitivanjima. Uzorak se uzima u skladu sa stavom 2. člana 17. ovog zakona.</p>
<p>5. Shpeshësia e verifikimit të cilësisë duhet të jetë në përpjesëtim me:</p>	<p>5. Frequency of quality verification shall be in proportion to:</p>	<p>5. Učestalost provere proizvoda treba da bude proporcionalna sa:</p>
<p>5.1. pandehjen e rrezikut të keqpërdorimeve, mbështetur në keqpërdorimet e dokumentuara nga vëzhgimi i vazhdueshëm;</p>	<p>5.1. presumption of the risk of misuse, based on the reports of the documented misuses from continuous monitoring;</p>	<p>5.1. sumnjom rizika od zloupotrebe, zasnovana na zloupotrebama dokumentovanim kontinuiranim osmatranjem;</p>
<p>5.2. detyrimet e Republikës së Kosovës për të zbatuar kërkesat nga legjislacioni i Bashkimit Evropian.</p>	<p>5.2. obligations that the Republic of Kosovo has for implementing the requirements deriving from the EU legislation.</p>	<p>5.2. obavezama Republike Kosovo da primeni zahteve iz zakonodavstva Evropske unije.</p>
<p>6. Qeveria me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përcakton:</p>	<p>6. The Government with a sub-legal act proposed by the Minister determines:</p>	<p>6. Vlada podzakonskim aktom koji predlaže ministar utvrđuje:</p>
<p>6.1. kushtet e përdorimit të aditivëve për të rritur cilësinë e karburanteve të lëngëta të naftës;</p>	<p>6.1. conditions of use of additives to increase the quality of liquid petroleum fuels;</p>	<p>6.1. uslove upotrebe aditiva za povećanje kvaliteta tečnih naftnih goriva;</p>
<p>6.2. raportin minimal vjetor të biokarburanteve të importuara ose të vendosura në treg ndaj karburanteve të tjera të përdorshme në transport;</p>	<p>6.2. the minimum annual ratio of biofuels imported or placed on the market to other fuels used in transport;</p>	<p>6.2. minimalni godišnji odnos biogoriva koja se uvoze ili stavljaju na tržište u odnosu na druga goriva koja se koriste u prevozu;</p>
<p>6.3. skemat mbështetëse për prodhimin dhe importimin e karburanteve të ripërtërishe.</p>	<p>6.3. support schemes for the production and import of renewable fuels.</p>	<p>6.3. šeme podrške za proizvodnju i uvoz obnovljivih goriva.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 13 Masat ndaj furnizimit të çrregullt</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 Measures against irregular supply</p>	<p style="text-align: center;">Član 13 Mere protiv neredovnog snabdevanja</p>
<p>1. Në rast të çrregullimeve në furnizimin me produkte të naftës ose karburante të ripërtërishme në tregun e brendshëm, Qeveria me propozim të Ministrit mund:</p> <p>1.1. të kufizojë orarin e punës së pikave të shitjes me pakicë;</p> <p>1.2. të kufizojë sasinë e produkteve që mund t'i shitet një konsumatori për çdo blerje ose brenda një periudhe të caktuar;</p> <p>1.3. të kufizojë lëvizjen e mjeteve motorike që përdorin karburante;</p> <p>1.4. të ndërmarrë masa të tjera për kufizimin e kërkesës ose konsumit, të rekomanduara nga organizatat ndërkombëtare;</p> <p>1.5. të lejojë standarde më të ulëta në cilësi, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian.</p> <p>2. Masat nga paragrafi 1 i këtij neni mund të zbatohen për një periudhë të caktuar kohore, por jo më gjatë se nëntëdhjetë (90) ditë pa ndërprerje.</p>	<p>1. The Government, upon the proposal from the Minister, in case of disruptions of supply with petroleum products or renewable fuels in domestic market, may:</p> <p>1.1. limit the working schedule at the retail point of sale;</p> <p>1.2. limit the amount of products that can be sold to a customer for each purchase or within a specified period;;</p> <p>1.3. limit the movement of motor vehicles that use fuels;</p> <p>1.4. take other measures to limit the demand or consumption, recommended by international organizations;</p> <p>1.5. Allow lower quality standards, in accordance with European Union legislation.</p> <p>2. The measures described in paragraph 1 of this Article may become applicable for a certain period of time, but not longer than ninety (90) days without interruption.</p>	<p>1. U slučaju poremećaja u snabdevanju naftnim derivatima ili obnovljivim gorivima na unutrašnjem tržištu, Vlada na predlog ministra može preduzeti sledeće mere:</p> <p>1.1. ograničavanje radnog vremena maloprodajnih mesta;</p> <p>1.2. ograničavanje količine proizvoda koji se mogu prodati kupcu za svaku kupovinu ili u okviru određenog perioda;</p> <p>1.3. ograničavanje kretanja motornih vozila koja koriste gorivo;</p> <p>1.4. preduzeti druge mere za ograničavanje potražnje ili potrošnje, preporučene od strane međunarodnih organizacija.</p> <p>1.5. dozvoljavanje nižih standarda kvaliteta, u skladu sa zakonodavstvom Evropske unije.</p> <p>2. Mere iz stava 1. ovog člana mogu se primenjivati na određeno vreme, ali ne duže od devedeset (90) dana bez prekida.</p>

<p align="center">Neni 14 Rregullimi i çmimeve</p>	<p align="center">Article 14 Price regulation</p>	<p align="center">Član 14 Regulisanje cena</p>
<p>1. Çmimet e produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme i përcakton tregu i lirë.</p> <p>2. Për të mbrojtur konsumatorin, për të mbrojtur konkurrencën, për të mënjeluar çrregullimet në treg ose për shkaqe të tjera të interesit shtetëror, Qeveria me akt nënligjor të propozuar nga Ministri përcakton rregullimin e çmimeve dhe masa të tjera mbrojtëse në këto raste:</p> <p>2.1. mungesa e papritur dhe e vazhdueshme e produkteve të naftës ose karburanteve të ripërtërishme;</p> <p>2.2. fatkeqësia natyrore;</p> <p>2.3. mospërshtatja e çmimeve vendore me lëvizje të mëdha të çmimeve në tregun botëror;</p> <p>2.4. dallimi i pajustificueshëm i çmimeve vendore nga çmimet në vendet fqinje.</p> <p>3. Rregullimi i çmimeve sipas paragrafit 2 të këtij neni përfshin caktimin e çmimit maksimal dhe të margjinës së lejuar të shitjes me shumicë dhe pakicë.</p>	<p>1. Prices of petroleum products and renewable fuels are determined by the free market.</p> <p>2. For consumer protection, protection of competition, for avoiding disruptions in the market or for other reasons of national interest, the Government shall, through a sub-legal act proposed by the Minister, determine the regulation of prices and other protective measures in the following cases:</p> <p>2.1. sudden and continuous shortage of petroleum products or renewable fuels;</p> <p>2.2. natural disaster;</p> <p>2.3. non-adjustment of local prices with great price movements in the world market;</p> <p>2.4. unjustifiable difference between local prices and prices in neighbouring countries.</p> <p>3. Regulation of prices according to paragraph 2 of this Article shall include the maximum sale prices or maximum margin in the wholesale and retail trade of fuels.</p>	<p>1. Cene naftnih derivata i obnovljivih goriva određuje slobodno tržište.</p> <p>2. Za zaštitu potrošača, za zaštitu konkurencije, za izbegavanje poremećaja na tržištu ili iz drugih razloga koji su od državnog interesa, Vlada podzakonskim aktom koji predlaže ministar utvrđuje regulisanje cena i druge zaštitne mere u sledećim slučajevima:</p> <p>2.1. iznenadna i kontinuirana nestašica naftnih derivata ili obnovljivih goriva;</p> <p>2.2. prirodna nepogoda;</p> <p>2.3. neprilagođavanje lokalnih cena sa velikim kretanjima cena na svetskom tržištu;</p> <p>2.4. neopravdana razlika između domaćih cena i cena u susednim zemljama.</p> <p>3. Regulisanje cena prema stavu 2. ovog člana uključuje određivanje maksimalne cene i dozvoljene marže veleprodaje i maloprodaje.</p>

<p>4. Për të hartuar aktin nënligjor nga paragrafi 2 i këtj neni, Ministri këshillohet me ministrin përgjegjës për financa, Autoritetin e Konkurrencës, Këshillin për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Shoqatën e Naftëtarëve.</p>	<p>4. In order to draft a sub-legal act from paragraph 2, the Minister shall consult with the responsible Minister of Finance, Competition Authority, the Consumer Protection Council and Kosovo Oilmen's Association.</p>	<p>4. Da bi izradio podzakonski akt iz stava 2, ministar se konsultuje sa ministrom nadležnim za finansije, Autoritetom za konkurenciju, Savetom za zaštitu potrošača i Udruženjem naftaša.</p>
<p>Neni 15 Detyrimet themelore të subjekteve</p>	<p>Article 15 Basic obligations of entities</p>	<p>Član 15 Osnovne obaveze subjekata</p>
<p>1. Për të mundësuar treg të sigurt dhe transparent, subjektet duhet:</p> <p>1.1. të mbajnë dhe të ofrojnë për shitje produktet vetëm nga rezervuarët, pompat, pajisjet për qitje dhe pajisjet e tjera të prodhuara për këtë qëllim;</p> <p>1.2. të mbajnë dhe të ofrojnë për shitje produkte që përmbushin standardet e cilësisë të përcaktuara me ligj ose akt nënligjor;</p> <p>1.3. të shfaqin qartë emërtimet, markat tregtare, simbolet, mbishkrimet dhe karakteristikat e tjera të produkteve që ofrojnë për shitje, sipas standardeve dhe kërkesave të ligjit dhe akteve nënligjore;</p> <p>1.4. të përdorin mjete matëse të sakta, me kalibrim dhe verifikim të vlefshëm, dhe të shfaqin sasinë e saktë të produktit që shitet;</p>	<p>1. To enable a secure and transparent trading, entities must:</p> <p>1.1. keep and offer for sale products only from tanks, pumps, dispensing equipment and other equipment designed for this purpose;</p> <p>1.2. keep and offer for sale products that meet the quality standards set forth by the law or sub-legal act;</p> <p>1.3. clearly display the name, trademark, symbol, inscription and other features of the products that are offered for sale, in accordance with the standards and requirements of the law and sub-legal act;</p> <p>1.4. use accurate measuring instruments which have valid calibration and verification, and display the exact quantity of product being sold;</p>	<p>1. Da bi omogućili sigurno i transparentno tržište, subjekti moraju:</p> <p>1.1. držati i nuditi na prodaju proizvode samo iz rezervoara, pumpi, opreme za točenje i druge opreme proizvedene u tu svrhu;</p> <p>1.2. držati i nuditi na prodaju proizvode koji ispunjavaju standarde kvaliteta utvrđene zakonom ili podzakonskim aktom;</p> <p>1.3. jasno prikazivati imena, zaštitne znakove, simbole, natpise i druge karakteristike proizvoda koje nude za prodaju, u skladu sa standardima i zahtevima zakona i podzakonskih akata;</p> <p>1.4. koristiti preciznu mernu opremu, sa važećom kalibracijom i verifikacijom, i prikazati tačnu količinu proizvoda koji se prodaje;</p>

<p>1.5. të shfaqin qartë emrin e subjektit, orarin e punës, llojet dhe çmimet e produkteve dhe shërbimet e tjera që ofrohen në pikën shitëse;</p> <p>1.6. të paraqesin informata dhe dokumentacion të vlefshëm dhe të saktë, në aplikimin për leje, gjatë mbikëqyrjes ose kurdo që kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;</p> <p>1.7. të ndërmarrin masa për të parandaluar rrjedhjen dhe për të zvogëluar ndikimin e rrjedhjes së produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtërishme, tretësve dhe lëndëve të tjera që ndotin mjedisin.</p>	<p>1.5. clearly display the name of the entity, working schedule, types and prices of products and other services that offered at the point of sale;</p> <p>1.6. present valid and accurate information and documentation, in the permit application, during supervision or whenever required by applicable law</p> <p>1.7. take measures for prevention of spills and mitigate the effect of spills of petroleum products, renewable fuels, solvents and other materials that pollute the environment.</p>	<p>1.5. jasno prikazivati naziv subjekta, radno vreme, vrste i cene proizvoda i drugih usluga koje se nude na prodajnom mestu;</p> <p>1.6. dostaviti validne i tačne informacije i dokumentaciju u aplikaciji za dozvolu, tokom nadzora ili kad god to zahteva važeći zakon;</p> <p>1.7. preduzeti mere za sprečavanje curenja i smanjenja uticaja curenja naftnih derivata i obnovljivih goriva, rastvarača i drugih materija koje zagađuju životnu sredinu.</p>
<p>2. Veprimtaria në kundërshtim me një dispozitë të nënparagrafëve 1.1–1.6 të këtij neni përbën praktikë mashtruese tregtare.</p>	<p>2. Activity contrary to provisions of subparagraphs 1.1–1.6 of this Article shall be deemed as Deceptive Trade Practice.</p>	<p>2. Delatnost suprotna odredbi tačkaka 1.1–1.6 ovog člana predstavlja obmanjujuću komercijalnu praksu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Pastrimi dhe mirëmbajtja</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Cleaning and maintenance</p>	<p style="text-align: center;">Član 16 Čišćenje i održavanje</p>
<p>1. Rezervuarët duhet të mirëmbahen, të kontrollohen dhe të pastrohen çdo gjashtë (6) vjet ose më shpesh sipas nevojës.</p> <p>2. Subjekti duhet të njoftojë Ministrinë para se të pastrojë rezervuarin ose të ndërrojë produktin e deponuar në rezervuar.</p>	<p>1. Tanks shall be maintained, inspected and cleaned every six (6) years or more frequently as needed.</p> <p>2. The entity must notify the Ministry before cleaning the tank or changing products stored in tanks.</p>	<p>1. Rezervoare treba održavati, pregledati i čistiti svakih šest (6) godina ili češće prema potrebi.</p> <p>2. Subjekat mora obavestiti Ministarstvo pre čišćenja rezervoara ili promene proizvoda uskladištenog u rezervoaru.</p>

<p>3. Inspektorati i Tregut ose organi tjetër kompetent mund të kërkojë kontrollimin ose pastrimin e rezervuarit nëse dyshohet për parregullsi ose në rrethana të jashtëzakonshme.</p> <p>4. Ministri me akt nënligjor përcakton kushtet, kriteret, procedurat dhe autorizimin e trupave për pastrimin e rezervuarëve.</p>	<p>3. The Market Inspectorate or another competent body may request the inspection or cleaning of tanks if irregularities are suspected in extraordinary circumstances.</p> <p>4. The Minister shall, through a sub-legal act, determine the conditions, criteria, procedures and authorization of the cleaning bodies for tanks.</p>	<p>3. Tržišna inspekcija ili drugi nadležni organ može zatražiti inspekciju ili čišćenje rezervoara ako se sumnja na nepravilnosti ili na izuzetne okolnosti.</p> <p>4. Ministar podzakonskim aktom utvrđuje uslove, kriterijume, postupke i ovlašćenja tela za čišćenje rezervoara.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Mbikëqyrja</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Supervision</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Nadzor</p>
<p>1. Mbikëqyrjen inspektuese e bëjnë Inspektorati i Tregut, trupat e autorizuar dhe organet e tjera kompetente, mbështetur në fushëveprimin dhe përgjegjësitë e tyre të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p>2. Mbikëqyrja bëhet:</p> <p>2.1. para hyrjes së karburantit në tregun e brendshëm;</p> <p>2.2. në tregun e brendshëm;</p> <p>2.3. te konsumatori ose pala tjetër.</p> <p>3. Qeveria me akt nënligjor të propozuar nga Ministri mund të përcaktojë:</p>	<p>1. Inspection supervision shall be performed by the Market Inspectorate, authorized bodies and other competent bodies based on the scope of activities and their responsibilities defined by law in power.</p> <p>2. Supervision is done:</p> <p>2.1. before the entry of fuel into the domestic market;</p> <p>2.2. in the domestic market;</p> <p>2.3. to the customer or the other party.</p> <p>3. The Government with a sub-legal act proposed by the Minister may determine:</p>	<p>1. Inspekcijски nadzor vrše Tržišna inspekcija, ovlašćena tela i drugi nadležni organi, na osnovu delokruga i njihovih odgovornosti definisanih važećim zakonodavstvom.</p> <p>2. Nadzor se vrši:</p> <p>2.1. pre ulaska goriva na unutrašnjem tržištu;</p> <p>2.2. na unutrašnjem tržištu;</p> <p>2.3. kod potrošača ili druge strane.</p> <p>3. Vlada, podzakonskim aktom predloženim od strane ministra, može da odredi:</p>

<p>3.1. fushëveprimin, përgjegjësitë dhe funksionimin e organeve kompetente dhe trupave të autorizuara;</p> <p>3.2. ngritjen e laboratorëve që mbështesin mbikëqyrjen e këtij ligji;</p> <p>3.3. mënyrën e mbikëqyrjes së këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 18 Ndëshkimet</p> <p>1. Për të caktuar lartësinë e gjobës brenda marginës së paraparë me këtë nen, kihen parasysh shkalla e devijimit nga kërkesat e këtij ligji ose akteve nënligjore që dalin nga ky ligj, vlera e përfitimeve ose e dëmeve të mundshme, si dhe rrethanat e tjera relevante.</p> <p>2. Kushdo që, në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji, pa leje shet me pakicë produkt të naftës ose karburant të ripërtërishëm, për secilën shitje, dënohet me gjobë:</p> <p>2.1. prej pesë mijë (5.000) deri në pesëmbëdhjetë mijë (15.000) euro, si person juridik;</p>	<p>3.1. scope, responsibilities and functioning of competent bodies and authorized bodies;</p> <p>3.2. the establishment of laboratories that support the supervision of this law;</p> <p>3.3. the manner of supervision of this law.</p> <p style="text-align: center;">Article 18 Penalties</p> <p>1. To determine the amount of the fine within the margin provided for by this article, the degree of deviation from the requirements of this law or sub-legal acts arising from it, the value of possible benefits or possible damages, and any other relevant circumstances shall be taken into account.</p> <p>2. Whoever, in contrary with Article 6 of this law, performs retail sale of petroleum products or renewable fuels for each sale shall be fined:</p> <p>2.1. from five thousand (5,000) to fifteen thousand (15,000) euros, as a legal entity;</p>	<p>3.1. delokrug, odgovornosti i funkcionisanje nadležnih organa i ovlašćenih tela;</p> <p>3.2. osnivanje laboratorija koje podržavaju nadzor nad ovim zakonom;</p> <p>3.3. način vršenja nadzora ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 18 Kazne</p> <p>1. Da bi se utvrdio iznos novčane kazne u okviru marže predviđene ovim članom, uzimaće se u obzir stepen odstupanja od zahteva ovog Zakona ili podzakonskih akata koji proizilaze iz ovog Zakona, vrednost potencijalnih koristi ili štete, kao i druge relevantne okolnosti.</p> <p>2. Ko god, suprotno sa članom 6. ovog Zakona, bez dozvole prodaje naftne derivate ili obnovljivo gorivo na malo za svaku prodaju kažnjava se novčanom kaznom:</p> <p>2.1. od pet hiljada (5.000) do petnaest hiljada (15.000) evra, kao pravno lice;</p>
---	---	--

<p>2.2. prej pesëqind (500) deri në një mijë e pesëqind (1.500) euro, si person përgjegjës i personit juridik;</p> <p>2.3. prej dy mijë (2.000) deri në pesë mijë (5.000) euro, si person fizik që ushtron biznes individual.</p> <p>3. Kushdo që, në kundërshtim me nenin 6 të këtij ligji, pa leje shet me shumicë ose deponon produkt të naftës ose karburant të ripërtërishëm, për secilën shitje ose secilin deponim, dënohet me gjobë:</p> <p>3.1. prej pesëmbëdhjetë mijë (15.000) deri në dyzet mijë (40.000) euro, si person juridik;</p> <p>3.2. prej një mijë e pesëqind (1.500) deri në katër mijë (4.000) euro, si person përgjegjës i personit juridik;</p> <p>3.3. prej tre mijë (3.000) deri në dhjetë mijë (10.000) euro, si person fizik që ushtron biznes individual.</p> <p>4. Kushdo që, në kundërshtim me nënparagrafin 1.6 të nenit 15 të këtij ligji, mashtron me origjinën ose dokumentacionin përcjellës të produktit të naftës ose karburantit të ripërtërishëm, për secilin mashtrim ose produkt, dënohet me gjobë:</p>	<p>2.2.from five hundred (500) to one thousand five hundred (1.500) euros, as a responsible person of a legal entity;</p> <p>2.3. from two thousand (2,000) to five thousand (5,000) euros, as a natural person conducting individual business.</p> <p>3. Whoever, in contrary with Article 6 of this law, sells or stores petroleum products or renewable fuel in bulk without permission, for each sale shall be fined:</p> <p>3.1.from fifteen thousand (15,000) to forty thousand (40,000) euros, as a legal entity;</p> <p>3.2.from one thousand five hundred (1,500) to four thousand (4,000) euros, as a responsible person of a legal entity;</p> <p>3.3.from three thousand (3,000) to ten thousand (10,000) euros, as a natural person conducting individual business.</p> <p>4. Whoever, in contrary with subparagraph 1.6 of Article 15 of this law, conducts fraud in regard to the origin or in accompanying documentation of petroleum products or renewable fuel, for each fraud or product, shall be fined:</p>	<p>2.2. od pet stotina (500) do hiljadu i pet stotina (1.500) evra, kao odgovorno lice pravnog lica;</p> <p>2.3. od dve hiljade (2.000) do pet hiljada (5.000) evra, kao fizičko lice koje vrši pojedinačno poslovanje.</p> <p>3. Ko god, suprotno članu 6. ovog Zakon, bez dozvole, prodaje na veliko ili skladišti naftne derivate ili obnovljivo gorivo za svaku prodaju ili svako skladištenje kažnjava se novčanom kaznom:</p> <p>3.1. od petnaest hiljada (15.000) do četrdeset hiljada (40.000) evra, kao pravno lice;</p> <p>3.2. od hiljadu pet stotina (1.500) do četiri hiljade (4.000) evra, kao odgovorno lice pravnog lica;</p> <p>3.3. od tri hiljade (3.000) do deset hiljada (10.000) evra, kao fizičko lice koje vrši pojedinačno poslovanje.</p> <p>4. Ko god, suprotno tački 1.6 člana 15. ovog Zakona, falsifikuje poreklo ili prateću dokumentaciju naftnih derivata ili obnovljivog goriva, za svako falsifikovanje ili proizvod, kažnjava se novčanom kaznom:</p>
---	--	---

